

BLLAGICA STOJMANOVSKA
SNEZHANA TRAJANOVIQ

TEKNOLOGJIA E PËRPUNIMIT TË KËPUCËVE

Për vitin III

DREJTIMI TEKSTIL-LËKURË TEKNIK I KËPUCËVE



Viti, 2012

Teknologjia e përpunimit të këpucëve

Botimi i parë

Autorë:

Bllagica Stojmanovska, inxh. e dipl.

Snezhana Trajanoviq, inxh. e dipl.

Recensentë:

Prof. dr. Lidija Naumovska

Prof. Ollgica Vellkoviç

Prof. Zagorka Bogdanska

Përkthyes:

Abdylmexhit Shaqiri

Redaktor i botimit ë gjuhën shqipe:

Prof. dr. Abdyl Koleci

Lektor:

Abdulla Mehmeti

Përgatitja kompjuterike:

Zharko Stojmanovski

Përgatitja teknike e fotografive:

Zharko Stojmanovski

Botuesi: Ministria e arsimit dhe shkencës e Republikës së Maqedonisë

Shtypi: Graficki centar doel, Shkup

Me Vendim për miratimin e tekstit mësimor për lëndën Teknologjia për përpunimin e këpucëve për vitin e tretë, drejtimi: tekstil-lëkurë, profili: teknik për këpucë, nr. 22-1009/1, i datës 14.06.2011, të sjellë nga Komisioni kombëtar për tekste mësimore.

CIP - Katalogizacija vo publikacija

Национална и универзитетска библиотека "Св.Климент Охридски", Скопје

АВТОР: Стојмановска, Благица - автор

ОДГОВОРНОСТ: Трајановиќ, Снежана - автор

НАСЛОВ: Технологија на изработка на обувки за III година текстилно-кожарска струка :
техничар за обувки

ИМПРЕСУМ: Скопје : Министерство за образование и наука на Република Македонија, 2011

ФИЗИЧКИ ОПИС: 116 стр. : илустр. ; 28 см

ISBN: 978-608-226-308-3

УДК: 685.34.01/02(075.3)

ВИД ГРАЃА: монографска публикација, текстуална граѓа, печатена

ИЗДАВАЊЕТО СЕ ПРЕДВИДУВА: 07.11.2011

COBISS.MK-ID: 89113354

Parathënie

Teknologjia e përpunimit të këpucëve mësohet edhe në vitin e dytë, ku është përfshirë e tërë procedura e përpunimit të pjesëve të sipërme të këpucëve, ose grykat e këpucëve.

Në lëndën Teknologjia e përpunimit të këpucëve për vitin e tretë, shtohen njohuritë e nxënësve nga fusha e njësive tematike për përpunimin e pjesëve të poshtme të këpucëve. Dorëshkrimi i tekstit mësimor për vitin e tretë përfshin shtatë njësi tematike.

Një njësinë e parë tematike janë përfshirë përmbajtje për materialet që përdoren për përpunimin e pjesëve të poshtme, si dhe prerja dhe përpunimi i pjesëve të poshtme.

Në njësinë e dytë, të tretë dhe të katërt tematike, janë përfshirë njësi mësimore për përpunimin e pjesëve dhe nën pjesëve të pjesëve të poshtme, siç janë: tabani, mes gjoni dhe gjoni, thembrat, takat dhe pjesët tjera përbërëse të pjesëve të poshtme të këpucëve.

Në njësinë e pestë tematike përfshihen njësi mësimore për bashkëngjijtjen e pjesëve të sipërme me tabanin, ndërsa në njësinë gjashtë tematike për prodhimin gjysmë të tërhequr me gjon dhe gjysmë gjon. Në njësinë tematike të shtatë me radhë dhe të fundit, janë dhënë përmbajtje mësimore për përfundimin e këpucës së gatshme, e cila si e tillë nxirret në treg. Kjo do të thotë se me përvetësimin e njësive tematike nga kjo lëndë, për vitin e dytë dhe të tretë, përmbyllet procesi i përpunimit të këpucëve.

Përveç pjesë tekstuale, në tekst janë dhënë edhe ilustrime dhe skema të pjesëve të veçanta, pjesëve dhe nën-pjesëve të brendshme për pjesët e poshtme.

Dorëshkrimi për vitin e tretë, për lëndën **Teknologjia e përpunimit të këpucëve** është përpiluar sipas planit dhe programit mësimor për vitin e tretë, të drejtimit për tekstil-lëkurë, profili teknik për këpucë. Lënda është përfshirë me tri orë në javë si lëndë e rregullt mësimore dhe dy orë si lëndë zgjedhore.

Nëse dorëshkrimi do të pranohet, ky do të jetë botimi i parë në gjuhën maqedonase dhe në gjuhën shqipe, të cilin do të mund ta përdorin nxënësit që studijorë për këtë profesion.

Gjatë përpilimit të tekstit janë vizituar disa ndërmarrje për përpunimin e këpucëve dhe janë realizuar konsultime me persona të specializuar në industrinë e përpunimit të këpucëve. E shfrytëzojmë këtë rast t'i falënderojmë të ata për bashkëpunimin dhe përkrahjen e tyre të sinqertë.

Autorët

PËRMBAJTJA

TEMA1. PRERJA DHE PËRPUNIMI I PJESËVE TË POSHTME TË KËPUCËVE

1.1 Pjesët përbërëse dhe ngjitja e pjesëve të poshtme.....	8
1.2. Materialet për përpunimin e pjesëve të poshtme.....	9
1.2.1 Lëkura natyrore për gjon.....	9
1.3 Zëvendësusi si material për pjesët e poshtme	11
1.3.1 Lëkura e regjeneruar.....	11
1.3.2 Materialet e celulozës.....	12
1.3.3 Materialet e smollës (rrëshinorë).....	13
1.4 Materialet prej gome në formë pllake.....	14
1.4.1 Materialet prej gome me formë jo pllake.....	15
1.5 Masat plastike si material për pjesët e poshtme të këpucëve.....	15
1.5.1 Masa polivinil klori (PVC).....	15
1.5.2 Masat poliuretani (PU).....	16
1.5.3 Masat plastike të ndryshme.....	17
1.5.4 Materialet tjera për pjesët e poshtme	17
1.6 Prerja e pjesëve të poshtme.....	18
1.7 Metodatat e prerjes së pjesëve të poshtme.....	19
1.8 Përgatitja për prerjen e pjesëve të poshtme të këpucëve.....	23
1.9 Organizimi i punës në repartin e prerjes.....	24
1.10. Përpunimi i pjesëve të poshtme të këpucëve	27
1.10.1 Shënimi i segmenteve prerëse	27
1.10.2 Rrafshimi-barazimi sipërfaqësor.....	27

TEMA 2. PËRPUNIMI I PRODUKTEVE TABANICË..... 30

2.1.Llojet dhe roli i produkteve tabanicë.....	30
2.1.1 Produktet tabanicë për këpucë të mbyllura me takë të ulët.....	30
2.1.2. Prodhimet e tabanicës për këpucë të mbyllura me takë të lartë.....	32
2.1.3 Prodhimet e tabanicës për këpucë të hapura.....	33
2.1.4 Prodhimet e tabanicës për këpucë me kuadrat.....	35

2.1.5 Produktet e tabanicë për llojet të tjera të kepuceve.	36
2.1.5.1 Tabanica për këpucë fleksibile verore.....	36
2.1.5.2 Tabanica për këpucë me qepje.....	37
2.1.5.3 Tabanica për këpucë të hapur me gjon të stërkatur.....	37
2.1.5.4 Tabanica për këpucë me lëkurë të kthyer-antipop.....	38

TEMA 3. PËRPUNIMI I GJONIT DHE MESGJONEVE..... 39

3.1 Roli dhe llojet e mesgjoneve.....	39
3.1.1 Mesgjonet me skaje të hapur.....	39
3.1.2. Mesgjoni me tehe me shirit.....	40
3.1.3 Mesgjoni me kanal.....	41
3.2 Përpunimi i gjoneve.....	42
3.2.1 Llojet dhe rolet e gjoneve (shputave).....	42
3.2.1.1 Gjonet që janë plotësisht mbi thembra.....	42
3.2.1.2 Gone që janë pjesërisht mbi thembra.....	43
3.2.1.3 Gjone të cilët janë të vendosur pranë dhe nën thembra.....	44
3.3 Përpunimi i gjoneve me mënyrë të montimit.....	45
3.4 Përgatitja e gjonit me kuadrat.....	46
3.5 Përpunimi i gjonit me nënthembra.....	47

TEMA 4. PËRPUNIMI I NËNTHEMRËS-TAKËS DHE PJESËVE TË TJERA TË POSHTME..... 49

4.1 Llojet dhe roli i nënthembrës.....	49
4.1.1 Nënthembra njëpjesëshe.....	50
4.1.2 Nënthembra e mbuluar me material shtresë.....	52
4.2 Nënthembra me shtresa.....	53
4.2.1 Nënthembra me shtresa që janë të ngjitura me thumbim.....	55
4.2.2 Nënthembra me shtresa prej materialeve të tjera.....	56
4.3 Llojet dhe roli i gjonit-kidir.....	56
4.4 Përpunimi i gjoneve.....	58
4.4.1 Përpunimi gjonit prej qafës dhe pjesëve anësore.....	58
4.4.2 Përpunimi i gjoneve prej lëkurës së rigjeneruar.....	59
4.4.3 Përpunimi i gjoneve prej materialeve smollë.....	59
4.5 Përpunimi i pjesëve të përparme	60

4.6 Përpunimi i kornizave.....	60
--------------------------------	----

TEMA 5. PËRGATITJA PËR PARATËRHEQJE DHE

TERHEQJE..... 63

5.1 Tërhrqja dhe ngjitja-(bashkimi) - karakteristikat e përgjithshme...	63
---	----

5.2 Operacionet deri te paratërheqja	64
--	----

5.2.1 Shpërndarja e tabanicës dhe kallëpit.....	64
---	----

5.2.2 Shpërndarja dhe rregullimi i pjesëve të poshtme.....	65
--	----

5.2.3 Hekurosje e pjesës së sipërme.....	66
--	----

5.2.4 Montimi dhe hekurosje e korsetit.....	67
---	----

5.2.5. Përforcimi i pjesës së sipërme me kallëpin në pjesën e thembrës.....	68
---	----

5.3 Paratërheqja dhe tërheqja - karakteristikat e përgjithshme.....	68
---	----

5.4 Paratërheqja pa tëheqje të majës (shpic).....	69
---	----

5.5 Paratërheqja me tërheqje të pjesës së përparme.....	71
---	----

5.6 Tërheqja e anëve.....	72
---------------------------	----

5.6.1 Tërheqja anësore me ngjitës.....	72
--	----

5.6.2 Tërheqja e anëve me thumb.....	73
--------------------------------------	----

5.7 Tërheqja e thembrës	75
-------------------------------	----

5.8 Përpunimi i gjysmëprodhimit të tërhequr.....	76
--	----

5.8.1 Largimi-heqja e rrudhave me lëshimin e tërhekur.....	77
--	----

5.8.2 Heqja e rrudhave të pjesës të përparme.....	78
---	----

5.8.3 Përpunimi i pjesës së thembrës të gjysmëprodhimit të tërhequr.....	78
--	----

5.8.4 Metodot tjera të përpunimit të pjesës së thembrës.....	79
--	----

5.9 Tharje e gjysmëprodhimit.....	79
-----------------------------------	----

5.10 Grithja e lëshimeve tërheqëse.....	81
---	----

5.11 Përforcimi i thembrës dhe pjesës së përparme.....	83
--	----

TEMA 6. NGJITJA E PJESËVE TË SIPËRME ME PJESËT E

POSHTME..... 85

6.1 Mënyrat e ngjitjes.....	85
-----------------------------	----

6.1.1 Ngjitje me thumbim-gozhdim.....	85
---------------------------------------	----

6.1.2 Ngjitja me qepje.....	86
-----------------------------	----

6.1.3 Ngjitje me qepje anësore.....	88
-------------------------------------	----

6.1.4 Ngjitja (bashkimi) me ngjitës.....	90
6.1.5 Ngjitja me spërkatje (shpric-stërpikje).....	92
6.1.6 Ngjitja me vullkanizim.....	93
6.1.7 Ngjitja e këpucëve shtëpijake-vendase.....	94
6.2 Përforcimi i nënthembrës.....	96
6.2.1 Përforcimi i nënthembrës me vidë.....	96
6.2.2 Përforcimi i nënthembrës me thumbim.....	97
6.2.2.1 Përforcimi i nënthembrës nga pjesa e poshtme.....	97
6.2.2.2 Përforcimi i nënthembrës nga ana e sipërme.....	98
TEMA 7. FAZA FINALE.....	101
7.1 Karakteristikat e përgjithshme.....	101
7.2. Operacionet e përpunimit mekanik.....	102
7.2.1 Prerja e skajeve të thembrave.....	102
7.2.2 Formësimi i skajeve të thembrat me renditje.....	103
7.3 Thikat për formësimin e thembrave dhe gjoneve.....	104
7.4 Grithja e skajeve të gjoneve dhe skajeve të thembrave të renditura.....	106
7.5 Përpunimi i sipërfaqes së shkeljes së gjonit.....	107
7.6 Përpunimet kimike të pjesëve të poshtme të këpucëve.....	108
7.6.1 Ngjyrosje e skajeve të gjoneve.....	108
7.6.2 Shëndritja (polirimi) e skajeve të gjonit.....	109
7.6.3 Ngjyrosja dhe shëndritja të sipërfaqes shkelëse të gjonit.....	111
7.7 Operacionet për përpunimin e pjesës së sipërme.....	111
7.8 Apretimi dhe karakteristikat e tyre.....	113
LITERATURA.....	116

TEMA 1. PRERJA DHE PËRPUNIMI I PJESËVE TË POSHTME TË KËPUCËVE

1.1 Pjesët përbërëse dhe ngjitja e pjesëve të poshtme

Pjesa e poshtme e këpucëve është ajo që bie në kontakt me sipërfaqen e tokës. Por pjesa e poshtme prodhohet si pjesë e veçantë dhe kjo ndryshon nga pjesa e sipërme. Në vend të pjesës së poshtme si njësi e veçantë, është prodhuar në mënyrë individuale komponentë në formë të veçantë, të tilla si shtruese, produktet e tabanicës së gjonit, thembra, thembra kuadrate, këmbë dhe shputa me pjesë të tjera. Me mënyrën e përpunimit të pjesës së poshtme përcaktohet metoda e marrjes, pjesa e sipërme e këpucës dhe pjesës së poshtme (fundeve të këpucës), i cili zhvillohet gradualisht, në disa faza:

- **Faza e parë:** vendosja e pjesës ndihmëse në pjesën e thembrës dhe të pjesës së përparme në pjesën e sipërme të këpucës;
- **Faza e dytë:** përforcimi i pjesës së sipërme e përforcuar me tabanicën, në prodhimtari përfitohet gjysmë prodhim;
- **Faza e tretë:** gjysmë prodhim është bashkimi mes gjonit (në qoftë se këpuca i përmban);
- **Faza e katërt:** bashkimi me gjonin shkelës dhe thembrën.

Pjesët e poshtme të këpucëve, dhe pjesët e sipërme të këpucëve, mund të grupohen në të:

- jashtme,
- brendshme,
- mes pjesë

Në pjesët e jashtme bëjnë pjesë: gjoni shkelës, gjysmë-gjoni për shkelje dhe thembra.

Në pjesët e brendshme bëjnë pjesë: tabanica bazë dhe tabanica mbuluesë.

Në mes pjesë janë: tabanica, pjesa që lidhet me gjonin, shtruese me përforcime metalike etj.

1.2. Materialet për përpunimin e pjesëve të poshtme

Për përgatitjen e pjesëve të poshtme përdoret lëkurë adekuate si dhe materiale të tjera: gomë, materiale plastike dhe zëvendësues të tjerë.

1.2.1 Lëkura natyrore për gjon

Kërkesa për thembra me gjon lëkure në të gjithë botën, në dekadën e fundit, është në rënie e sipër dhe shfrytëzohet gjoni sintetik. Ndërmarrjet e njohura botërore për përpunimin e këpucëve përdorin gjon natyror vetëm me regjie bimore, i cili është me cilësi më të lartë. Përpunimi i lëkurës për gjon varësisht prej regjjes është bimor, apo i kromit të sulfatit, varësisht nga qëllimi i përdorimit. Ndarja kryesore e lëkurës për gjon varet nga:

- cilësia, dhe
- qëllimi

Sipas **cilësisë**, ndarja varet nga cila pjesë e kafshëve merret, kështu që ka tri zona të cilësisë së mirë të lëkurës:

- Pjesa e shpinës ose kreponi - cilësi më e mirë,
- Pjesa e qafës – cilësi mesatare,
- Pjesa e fundit – cilësore - jocilësore.

Pjesa e shpinës- kreponi, karakterizohet me përbërje më të mirë strukturale, është më e qëndrueshme ndaj ujit dhe lagështisë dhe e ka shkallën më të ulët të dëmit. Përdoret për prodhimin e gjonit me cilësi të lartë dhe takë, thembra këpucësh dhe pjesën e poshtme të takës (pjesa e poshtme e thembrës-takës). Pjesa e shpinës përfshin rreth 48% të sipërfaqes të përgjithshme të lëkurës.

Pjesa e lëkurës së qafës-te lëkura e qafës, përbërja strukturale është më pak e barazuar dhe me më pak lëshim të ujit dhe lagështisë. Përdoret për përpunimin e tabanicë, pjesë të brendshme të gjonit, dhe thembra për këpucë me konstruktim të lehtë. Kjo ka sipërfaqe rreth 25% të lëkurës natyrore.

Pjesa e fundit: ka ndërtim strukturor të pabarabartë, dhe për këtë shkak, më tepër bën lëshimin e ujit dhe lagështisë. Ka sipërfaqe të pabarabartë dhe shkallë më të madhe të dëmit. Përdoret për prerjen e tabanicës me cilësi të mirë, pjesë të brendshme-kidir, gjon të brendshëm dhe thembra për këpucë. Sipërfaqja

e përgjithshme është deri 27%. Prandaj, pjesa e fundit përdoret kryesisht për tabanicë, për shkak se ajo e thith djersën dhe e lëshon lagështinë që krijon një këpucë gjatë mbajtjes (shih figurën 1).




Figura 1. Ndarja e cilësisë së lëkurës

Sipas **qëllimit**, përdorimit të lëkurës, ajo ndahet në:

- lëkurë komerciale,
- lëkurë speciale,
- lëkurë e mëparshme.

Lëkura komerciale për thembra: me përpunimin e lëkurës blen prona të tilla si dendësi maksimale e kolagjenit dhe fibrave sasi minimale të materialeve të pavarura dhe e regjur rreth 3% yndyrë. Ajo përdoret për të bërë thembra të cilat ngjiten me goditje me çekan.

Lëkura speciale për thembra: kur përpunimi është i ngjeshur normalisht, përmban 3% të materieve të palidhura dhe të regjura 5% yndyrë. Kjo përdoret për të përfituar thembra që ngjiten me qepje.

Lëkura Ago për thembra: me përpunimin minimal është e ngjeshur, e cila përmban materie të regjura pa lidhje, dhe përmban yndyrë 2.5%. Kjo përdoret për të përfituar thembra të cilat ngjiten me ngjitëse.

1.3 Zëvendësuesi si material për pjesët e poshtme

Përveç lëkurës, për prodhimin e pjesëve të poshtme të këpucëve përdoren materiale, të cilat mund të merren në masë më të vogël ose më të madhe për të zëvendësuar materialet natyrore. Materialet e tilla quhen materiale homogjene.

Lëkura natyrore ka trashësi të pabarabartë dhe të ndërtimit strukturor, si dhe dëmtime më të mëdha në sipërfaqe të lëkurës që dukshëm mund të shihen edhe me sy të lirë.

Zëvendësuesit, për dallim nga materialet natyrore, janë të karakterizuar me karakteristikat e mëposhtme:

- ndërtim strukturor të barabartë (të unifikuar),
- pa dëmtime në sipërfaqe,
- jep një shkallë më të madhe të përdorimit të materialit,
- është më e përshtatshme për përpunim, më e dobishme dhe nevojshme për pjesët e poshtme të këpucëve,

Si lëkurë natyrore, po ashtu edhe zëvendësuesi, që të përdoret për përgatitjen e pjesëve të poshtme të këpucëve, duhet të ketë disa karakteristika, si:

- shkalla minimale e pranimit të lagështisë,
- thithjen e lagështisë dhe djersës,
- të jetë më e lehtë se lëkura,
- të jetë elastike,
- të ketë qëndrueshmëri mekanike,
- temperaturë të qëndrueshme,
- e përpunueshme në aspektin e këpucës.

Zëvendësuesi që përdoren për pjesët e poshtme janë: regjenerues të lëkurës, materiale celuloze, materiale plastike, pllaka gome, pjesë të stërpikura, produkte të metaleve dhe të tjera.

1.3.1 Lëkura e regjeneruar

Lëkura e regjeneruar përfitohet nga mbeturinat gjatë përpunimit të lëkurës që shfaqen si humbje të industrive për prodhimin e, veshjeve, këpucëve dhe

galanterisë. Sipas kësaj varet nga prejardhja e mbeturinave prej regjjes bimore ose lëkurës së regjur me krom, ka dy lloje të lëkurave të regjeneruara:

- bimore,
- të kromit.

Mbeturinat e lëkurës janë pjesë të vogla, largohen substancat e pa lidhura të regjjes dhe pastaj, në mënyrë që rezulton mblidhen fibrat e ngelura ngjiten me masë prej gome ose me mjete të tjera të detyrueshme dhe në fund formohen në formë të pllakave, me trashësi të ndryshme 1,8-2 mm.

Regjeneratori bimor është rezistent ndaj ujit dhe lagështisë, por nuk është rezistent ndaj temperaturës së lartë. Nga ana tjetër, në temperaturat e larta fitojnë plasticitet më të madh dhe më lehtë mund t'i jepet formë e duhur.

Materiali i regjeneruar i kromit: është i qëndrueshëm ndaj ujit dhe lagështisë, rezistent ndaj temperaturave të larta, ka plasticitet të ulët dhe për këtë arsye është e vështirë për formësim.

Si regjenerues bimorë dhe regjeneruesi i kromit është po ashtu fleksibil në të gjitha drejtimet dhe bashkimi mund të bëhet me ngjitje dhe qepje. Kryesisht përdoret për të bërë pjesë ngjitëse-kidir.

1.3.2 Materialet e celulozës

Materialet e celulozës prodhohen me recetë dhe teknologji të ndryshme, e cila varet nga qëllimi i tyre. Materialet e celulozës mund të prodhohen në formën e:

- Ngjitëses,
- Teksone,
- Celteks.

Ngjitësi prodhohet në formën e tabelave 0,5-3,5 mm, që varet nga zbatimi i tij. Për forcimin e pjesës ndihmëse të pjesës së thembrës përdoret ngjitëse me trashësi 2-2,5 mm, kurse për përforcim përdoret me trashësi prej 1mm. Ngjitësi është një material i celulozës që duhet të ketë aftësi për të formuar ngjitje dhe të jetë rezistent ndaj presionit gjatë formësimit, presioni rritet kurse ngjitësi është i ekspozuar gjatë përgatitjes.

Tekson dhe Celteks: si dhe materialet tjera të ngjashme janë bërë edhe në formë të tablove apo pllakave të një trashësie prej 1 - 1.5 mm. Ato karakterizohet me:

- peshë të lehtë,
- elasticitet dhe rezistencë të lartë,
- lehtë përpunohet me presim pa deformime,
- mund të ngjiten dhe qepen,
- kanë lëshime të pjesshme të ajrit dhe thithjes së djersës,
- të sigurojnë një mikroklimë të favorshme për këmbët,
- pjesërisht janë rezistentë ndaj ujit dhe lagështisë.




Figura 2

1.3.3 Materialet e smollës (rrëshinorë)

Materialet rrëshinorë-smolla: sikurse edhe celuloza janë bërë në formën e pllakave. Mund të përpunohet si: smollë njëanëshe, dy anë smollë, e ngurtë, elastike etj. Përdoren për përfitimin e shputës së butë dhe të fortë. Kanë një nivel më të lartë të përpunimit se materialet tjera. Është e mundur që prerja të bëhet në shtresa, pas prerjes zhvillohet një numër i vogël i operacioneve të përpunimit dhe këto operacione janë shumë të thjeshta. Ajo karakterizohet nga:

- rezistencë e nevojshme mekanike,
- rezistencë ndaj ndryshimeve të temperaturës,
- mund të formësohet në gjendje të nxehtë.

1.4 Materialet e gomës në formë pllake

Goma prodhohet në formën pllakave, dhe përpunohen si:

- Gomë elastike,
- Gomë e zgjeruar,
- Gome transparente,
- Gomë neoliti,
- Gomë krep.

Goma elastike në përbërjen e saj përmban një sasi të madhe elastomere, dhe për këtë arsye ka një fortësi të vogël, peshë të vogël dhe shkallë të ulët të përpunimit. Prerjet, qepjet dhe gërvishtjet zhvillohet vështirë. Ngjitja është e mundur vetëm me dy komponentë ngjites. Nëse e zvogëlojmë sasinë e elastomerit rritet shkalla e përpunimit.

Goma e zgjeruar përmban sasi të madhe të ngarkesave që e rritin shkallën e përpunimit, që do të thotë se prerja kryhet pa vështirësi, ndërsa gërvishtjet dhe qepjet janë normale me zvogëlimin e shpimeve në një centimetër.

Nëse zvogëlohet sasia e ngarkuesit, atëherë rritet shkalla e përpunimit. Gjatë procesit të përfitimit të gomës së zgjeruar krijon hapjen e poreve, sepse ky lloj i gomave është quajtur gomë mikroporoze.

Goma transparente: karakterizohet me transparencë të lartë, e cila është gomë transparente. Përfitohet me recetë të duhur me sasi të zvogëluar të djegies.

Neoliti: është një gomë smolle, material në formën e pllakave, ku smolla është përdorur si një plotësues ngjites i materialit. Ka një shkallë të vogël të përpunimit, që do të thotë, procesi i qepjes nuk është i mundur, grithja bëhet me vështirësi dhe nëse bëhet grithje me përdorim të letrës grithëse me numeracion të vogël. Megjithatë prerja dhe hollimi kryhet pa vështirësi. Neoliti prodhohet si i ngjyrosur dhe brinjor.

Neoliti i ngjyrosur është i ngjashëm me lëkurën e rëndë, të quajtur brinjëzor sepse është imitim i profilizuar për thembrat e gomës.

Goma krep: paraqet material gome me një sasi të zvogëluar të sulfurit, dhe ka pamjen e kauçikut natyral, për atë ka sipërfaqe me ngjyrë të verdhë.

1.4.1 Materialet prej gome me formë jo pllakë

Goma përfitohet me vullkanizim në formën e shabllonit në të cilin bëhet vullkanizimi. Ashtu që përfitohet gomë e profilizuar në formë të gjonit, e formatizuar ose e pa formatizuar që do të formatizohet në proceset e mëtejshme. Në mënyrë të ngjashme nëpër shabllone përfitohen edhe thembra gjoni termoplastike.

1.5 Masat plastike si material për pjesët e poshtme të këpucëve

Masat plastike sot përdoren gjithnjë e më tepër për të bërë thembra, thembra me takë, shputë këpucë etj.

1.5.1 Masa polivinil klori (PVC)

Masa e polivinilkloridit përfitohet prej polivinil klorit me plotësues për shkrirje dhe me preparate të tjera ndihmëse. Për përfitimin e tyre përdoren granulat e PVC prej të cilës përfitohen thembra dhe shputa këpucë me spërkatje–stërpikje.

Thembra PVC karakterizohen me:

- rezistencë të lartë zgjerimi,
- rezistencë normale ndaj këputjes,
- lëshim të mjaftueshëm të energjisë elektrike,
- rezistencë e kufizuar ndaj substancave kimike,
- fortësi të mjaftueshme,

- nuk lëshojnë lagështi, nuk prishen, nuk lënë gjurmë, janë të qëndrueshme në ndryshimet e temperaturës dhe nuk japin erë të keqe të këmbës.

1.5.2 Masa e poliuretanit (PU)

Masa e poliuretanit, për shkak të përparësive të caktuara, sot ka përdorim më shumë se PVC për përpunim të thembrave me shputë dhe gjon shpute, dhe ata janë:

- qëndrueshmëri më të madhe,
- deri tre herë më e lehtë se thembra e PVC-së,
- rezistencë më të madhe të ujit dhe lagështisë,
- nuk rrëshqasin në sipërfaqe me lagështi dhe lënë gjurmë gjatë ecjes.

Përveç përparësive thembrat e gjonit prej poliuretani kanë edhe këto mangësi:

- gjatë mbathjes së këpucës vjen deri te mbledhja e thembrës,
- mangësitë që bëhen gjatë spërkatjes, dhe nuk mund të ripërpunohen për shkak të plasticitetit të ulët,
- japin kushte të vështira për punë,
- siguria në punë është e komplekse, për shkak se poliuretani përfitohet me esterifikimin e alkoolit dhe izocianitit, dhe gjatë kësaj krijohet sasi e caktuar e gazrave toksikë.



Figura 3. Gjon-thembra prej poliuretani

1.5.3 Masa plastike të ndryshme

Masa plastike përdoret edhe për përfitimin e thembrave të quajtura thembra një pjesësh.

Për këto nevoja përdoren masa plastike të polipropilenit polistirenbutadine. Masa plastike e polipropilenit përfitohet me polimerizimin e propilenit, e cila përdoret për përgatitjen e thembrës.

Masa plastike polistirenbutadine përfitohet me kopolimerizimin e stirenit dhe butadienit, e cila më pas përdoret gjithashtu për përfitimin e thembrës një pjesësh.

Në krahasimin e thembrave mes veti, përparësi kanë polistirenbutadinet, edhe pse janë të rënda dhe më të shtrenjta, ato janë më të lehta për grithje, lehtë nxirren nga këmba dhe përdoren ngjitës një komponentësh, më lehtë shtrihen mbi gjon dhe nuk thyhen.

1.5.4 Materialet tjera për pjesët e poshtme

Për përgatitjen e pjesëve të poshtme të këpucëve përdoret, çeliku dhe druri. Çeliku përdoret për forcimin e këmbës (kyçin e këmbës), përforcim i cili është ndërtuar te thembra e këmbës. Detyra e tij është që të sigurohet vendosja e duhur e këmbës dhe të parandalojë deformim të njëjtë.

1.6 Prerja e pjesëve të poshtme

Operacioni fillestar për përfitimin e pjesë të poshtme të këpucëve është prerja e pjesës së poshtme, e cila kryhet me prerje. Prerja zhvillohet me presa për prerje ose makina automatike për prerje. Kjo është e nevojshme për të plotësuar kërkesat e caktuara për cilësinë e pjesëve të prera, dhe ata janë:

- që puna të jetë produktive,
- shfrytëzimi i plotë i materialeve,
- të sigurohet kualitet i nevojshëm gjatë prerjes në çifte.

Për prerjen e pjesëve të poshtme përdoren:

- presa mekanike,
- presa hidraulike.

Presat mekanike përmbajnë traun ramës ose rrezin, dhe ekzistojnë presa në formë të pjatës. Në çdo rast, prerja bëhet nga shtypja e thikës që është e vendosur më parë për prerjen e materialeve. Pas prerjes të materialit, tehu i thikës vendoset në sipërfaqen e tavolinës së punës të makinës për 1mm, nëse lartësia e shtyllës ramëse është e rregulluar mirë.

Presat hidraulike kanë edhe gjysmëtrarë apo trarë. Prerja zhvillohet nën ndikimin e presionit. Makinat hidraulike për prerjen e materialeve komplekse kryhet në një numër të shtresave (materialeve homogjene), dhe është e mundur për kryerjen e prerjes dhe të një shtrese të lëkurës.

Aparatet për prerjen e pjesëve të poshtme janë shumë produktive, sepse realizohet prerje e programuar dhe lëvizje të materialit.

Thikat për prerje të pjesëve të poshtme të këpucëve janë prodhuar:

- me lëshim,
- pa lëshim,
- të ulëta,
- të larta.

Thikat me lëshim bëjnë lëshimin ose marrin çdo pjesë duke plotësuar plotësisht pjesët, atëherë të gjitha në të njëjtën kohë tërhiqen.

Thikat pa lëshim bëjnë prerjen e vetëm një apo dy pjesëve, sepse kanë mbrojtës i cili i refuzon.

Thikat e lartë kanë një lartësi 100 ose mbi 100 mm, të përdorura për prerjen e pjesës së poshtme të materialeve të forta dhe materialeve të trasha (ngjitëse, krupon etj.).

Thikat të ulëta janë rreth 32 mm. Ato përdoren për prerjen e lëndëve të holla dhe të buta. Për prerjen e thembrave, shtrueseve dhe pjesëve të tjera, për çdo numër përdoret thikë e veçantë dhe për prerjen e pjesës së poshtme (kidir), për forcimin e thembrës së këmbës, një thikë përdoret për prerjen e dy ose tri madhësive.

Si bazë për të bërë thika përdoret shablloni që do të prodhojë modele të përshtatshme. Prandaj, në praktikë, modeli është aplikuar për të shënuar kallëp që i takon tehut të thikës që është i përshtatshëm për përdorim.

1.7 Metodat e prerjes së pjesëve të poshtme

Për prerjen e pjesëve të poshtme duhet të plotësohen kushte të caktuara, si:

- a) pjesët përbërëse të jenë me veti të barabarta,
- b) të shfrytëzohet plotësisht materiali,
- c) koha e prerjes të jetë minimale,
- d) të përdoren vetëm fondet e nevojshme.

Të gjitha këto kushte mund të plotësohen plotësisht vetëm në materiale homogjene, sepse ato kanë karakteristika të barabarta në të gjithë sipërfaqen. Në të gjitha materialet natyrore kushtet e përmendura më parë nuk mund të përmbushen për shkak të ndërtimit të pabarabartë dhe vetive strukturore në sipërfaqe.

Për prerjen e pjesëve të poshtme shpesh aplikohen metodat e mëposhtme ose sistemet e prerjes:

- Sistemi në të njëjtën mënyrë, me një dhe dy thika,
- Sistemi në kahje të kundërt me një dhe dy thika,
- Sistemi diagonal,
- Sistem i ndryshuar.

Sistemi në të njëjtën kahje, ku sistemi synon thikat e prerjes, janë vendosur në të njëjtin drejtim. Te sistemi me të njëjtën kahje dhe mënyrë me **një thikë**, prerja është kryer në mënyrë prej një lëkure që janë prerë vetëm pjesët e djathta, dhe pjesët tjera të lëkurës priten vetëm në të majtë (Figura 4). **Mangësi** e mënyrës së kësaj prerje është se pjesët nuk janë të vetive të barabarta, dhe arrijnë shfrytëzimin e plotë të materialit, koha minimale dhe kushtet teknologjike ku aplikohen vetëm mjetet e nevojshme.




Figura 4. Sistemi i njëjtë në një kahje me një thikë

Te sistemi i njëjtë, me një kahje me dy thika, prerja gjithashtu kryhet në drejtim të njëjtë, vetëm se një rresht bën prerjet e majta të pjesëve, kurse në rreshtin tjetër bën prerje të djathtë të materialit. Figura 5. Në këtë mënyrë të prerjes **mangësi** e prerjes teknologjike është se koha është më e gjatë, për shkak të ndryshimit të drejtimimit të prerjes, dhe kushtet e tjera janë plotësuar.




Figura 5. Sistemi me kahje të njëjtë me dy thika

Sistemi me kahje të ndryshme - është kur thikat e prerjes janë të vendosura në dy radhë të kundërta. Te sistemi i kundërt me një thikë, prerja kryhet në dy rreshta të kundërt dhe një lëkurë të prerë vetëm të majta, si dhe të produkteve të tjera vetëm të djathta të lëkurës. Mangësi-në këtë mënyrë të prerjes është se pjesët

përbërëse nuk janë me veti të barabarta, dhe kushtet e tjera janë plotësuar (shih figurën 6).




Figura 6. Sistemi me kahje të kundërt me një thikë

Te sistemi me kahje të kundërt me, prerja kryhet në dy rreshta të kundërt të cilët një rresht priten pjesët e majta, kurse në rreshtin tjetër priten prodhimet e djathta (Fig. 7). Mangësitë, sepse koha teknologjike është më e madhe për shkak të ndryshimit të drejtimit të prerjes, dhe kushtet e tjera janë plotësuar (Fig. 7).




Figura 7. Sistemi me kahje të kundërt me dy thika

Sistemi diagonal-zbatohet në rastin kur duhet të bëhet prerja e pjesëve përbërëse, në mënyrë rigoroze me veti të barabarta. Gjatë prerjes, pjesët vendosen në mënyrë që thembra prek thembrat dhe majën me majën në rreshtin e parë, ndërsa rreshti i dytë, takohet maja me majën ku trajtimin e parë të përputhjes thembra me thembër, si dhe anasjelltas (Fig. 8).

Mangësi-në këtë mënyrë është se koha teknologjike është më e madhe për shkak të ndërrimit të thikave për prerje ose mund të përdoret thika me dy tehe.




Figura 8. Sistemi diagonal

Sistemi i ndryshueshëm - mund të jetë në të njëjtën mënyrë me 1 dhe 2 thika ose të drejtuara ndryshe nga 1 dhe 2 thika. Kjo metodë e prerjes zbatohet kur sipërfaqja e lëkurës ka disa dëmtime, kështu që kjo mënyrë e vendosjes së thikave mund të shmang të gjitha dëmtimet (Fig. 9).




Figura 9. Sistemi i ndryshueshëm

1.8 Përgatitja për prerjen e pjesëve të poshtme të këpucëve

Para se të filloni procesin e prerjes së pjesëve të poshtme të këpucëve, është e nevojshme të kryhet parapërgatitja e repartit për prerjen e pjesëve të poshtme. Përgatitja arrihet në mënyrë që:

- materiali të merret prej repartit të e radhitjes-magazinë,
- marrja e thikave për prerje të cilat gjithashtu janë në vende të caktuara dhe për qëllim të caktuar.

Në repartin e përgatitjes materialet ruhen në rafte sipas llojit të materialit dhe të cilësisë, trashësisë, ngjyrës, etj. (Fig. 10).

Lëkurat herë pas here duhet të kthehen dhe rrotullohen. Temperatura në magazinën e lëkurave të përfunduara duhet të mbahet konstante, 18-20 °C dhe me lagështi relative të caktuar.

Marrja e materialit- marrja e materialit prej magazine kryhet nga punonjësit e rendit të punës (përgjegjësit), i cili duhet të përmbajë të gjitha të dhënat e nevojshme të materialit (ngjyra, sasia, çmimi, klasa dhe trashësia e materialit). Pas pranimit të materialit kryhet kontrollimi i të gjitha të dhënave për materialin, që janë të shënuara të dhënat në udhëzimin e punës.

Kujdes të veçantë duhet t'i kushtohet trashësisë së materialit dhe nuk duhet të merren materiale me trashësi jo të njëjtë, shumë të trasha ose shumë të holla. Nëse materiali është me trashësi më të vogël atëherë duhet të përforcohet me pjesë ndihmëse, e cila nuk është i rekomanduar. Nëse materiali është me trashësi më të madhe, punonjësi pranon sasi më të vogël të materialit, i cili çon në humbjen e materialit dhe duhet të shkojë në dëm të punëmarrësit.

Materialet të cilat shpërndahen në bazë të udhëzimit, urdhrave punëtorit i dërgohet në vendin e punës për të punuar, të cilat janë të kontrolluara në bazë të të dhënave që t'u përmbahet urdhrave të punës, atëherë mund të fillojë prerja sipas metodës së përmendur më parë apo sistemeve për prerje.

Materialin e pranuar mund ta ndjekin një ose më shumë udhëzime të punës. Në udhëzimin e punës janë të definuara dhe detyrat e punëtorit, për shembull, në cilat pjesë duhet bëjë prerje dhe në të cilat madhësi dhe sasi për çdo numër. Nëse një punonjës kryen prerjen e më shumë llojeve të pjesëve të prerjes, atëherë duhet të merr më shumë udhëzime, urdhra pune.

Thikat për prerje gjithashtu duhet të merren nga reparti i thikave që janë të vendosura sipas kontrollit në rafte të veçanta. Kontrollimi i thikave është i domosdoshëm, për shkak se dëmtohen ose lakohen gjatë procesit të punës. Thikat dhe materialet jepen sipas urdhrit të punonjësit që kryen prerjen dhe ajo vazhdon të punojë deri sa të mbarojë udhëzimin-urdhurin e punës për ta kryer prerjen sipas urdhrit të punës.



Figura 10. Reparti për radhitjen -ruajtjen e materialeve për pjesët e poshtme

1.9 Organizimi i punës në repartin e prerjes

Organizimi në repartin e prerjes rrjedh nga nevojat e detyrave që do të kryhet në këtë departament. Sipas nevojës dhe në kohë të caktuar duhet siguruar sasinë e nevojshme dhe sipas numrave të përcaktuar sipas madhësisë për të gjitha modelet dhe llojet e këpucëve që dalin nga plani i prodhimit.

Në repartin e përpunimit të pjesëve të poshtme, njëkohësisht punohen modele të ndryshme ose sasi të ndryshme të mbathjeve. Për këto arsye, puna në këtë repart duhet të jetë mirë e organizuar. Normalisht që çdo punëtor, rrobaqepës të bëjë prerjen e të gjitha pjesëve të këpucëve prej materialeve të ndryshme, p.sh., thembra dhe pjesa e shputës, gjonit, shtrueses, kyçeve të këmbës dhe kështu me radhë dhe të gjitha pjesët e këpucëve, në sasi të barabartë, për shembull, 100 ose 500 çifte.

Kjo mënyrë e organizimit për prerje mund të aplikohet në rast se çdo punëtor është i aftë dhe i specializuar për prerje e të gjitha pjesëve të ndryshme e të gjitha llojeve të materialeve dhe kështu të arrijë cilësinë e kërkuar. Ekzistojnë punëtorë të specializuar të cilët mund të kryejnë prerjen e vetëm një lloji të materialit, të tilla si thembra neolitike etj.

Detyrat e punëtorit-qepësit të mbathjeve:

- bën prerjen e pjesëve përbërëse sipas udhëzimit të punës,
- të ketë parasysh prerjen e drejtë dhe shfrytëzimin racional të materialit, dhe kjo do të arrihet me zgjedhjen e duhur dhe në mënyrë të përshtatshme të prerjes,
- bën kontrollin e punës së vetë, sipas madhësisë së numrit dhe cilësisë,
- kontrollon trashësinë e pjesëve të prera dhe i largon pjesët me trashësi më të vogël të dhënë në udhëzimin e punës. Për matjen e trashësisë përdoret mikrometër.
- pjesët e prera radhiten sipas numrit të çifteve të caktuar (në palë) dhe njoftohet udhëheqësi i repartit se programi i punës është përfunduar. Pjesët e përfunduara shkojnë në përpunim të mëtejshëm.

Shfrytëzimi racional i materialit është shumë i rëndësishëm për funksionimin ekonomik, në këtë mënyrë ndjekjet në nivel të njëjtë në repart për çdo punëtor individualisht. Kualiteti kontrollohet vazhdimisht, pas çdo faze, në nivel të repartit dhe për çdo punëtor individualisht.

Detyrat kryesore të menaxherit janë:

- planifikimi i prodhimit,
- bashkëpunimi me përgatitjet operative dhe përgatitjen e dokumentacionit,
- të sigurojë kushtet dhe mjetet e punës,
- realizimin e planeve të prodhimit.

Radhitja e numrave sipas madhësisë	36	37	38	39	40	41	
Nunrat sipas madhësisë për 100 palë	5	20	20	30	20	5	100
Radhitja e numrave sipas madhësisë për numrin e përgjithshëm të prodhimit	5*35 175	20*35 700	700	1050	700	175	3500
2% Mbeturinat, etj.	180	720	720	1070	720	180	3590
Orari i punës ditore I numrave sipas madhësisë	180/4 45	720/4 180	180	267	a80	45	898

Tabela nr.1

1.10. Përpunimi i pjesëve të poshtme të këpucëve

1.10.1 Shënimi i segmenteve prerëse

Pjesët e prera dhe të përfunduara dorëzohen në repart për përpunimin e pjesëve të poshtme të këpucëve. Këtyre pjesëve të përgatitura së pari u bëhet kontrollimi i kualitetit të prerjes dhe pastaj bëhet etiketimi.

Nënvizimi mund të kryhet me makinë për nënvizim, e përbërë nga elemente metalike në formën e shkronjave ose numrave. Me këto elemente metalike bëhet shtypja e elementeve në thellësi prej 1 mm. Nëse shtypja (nënvizimi) nuk është mjaft e qartë, për shkak të trashësisë së pabarabartë të materialit atëherë bëhet barazimi i sipërfaqes dhe pastaj nënvizimi.

Shënimi i të gjitha elementeve mund të kryhet edhe me shtypje me ngjyra, p.sh., te thembra tekson.

1.10.2 Rrafshimi- barazimi sipërfaqësor

Rrafshimi i sipërfaqes zbatohet vetëm në pjesët e poshtme të materialit natyror të prerë. Zbatohet me qëllim që pjesët e prera të përfitojnë veti të barabarta, ose të përfitohet trashësi e njëjtë në të gjithë sipërfaqen. Kjo kryhet te gjoni prej lëkure dhe tabanicë, si dhe te kidiri i përbërë prej qafës dhe pjesëve anësore. Ky operacion mundëson veprime kualitative edhe te operacionet tjera, për shembull: shtypjen e thembrave, formësimin e tabanicës dhe përforcimin e thembrës me pjesën e sipërme dhe kidirin.

Rrafshimi i sipërfaqes (hollimi) kryhen në **makinë me thikë të palëvizshme dhe dy cilindra transporues**, ku cilindri i poshtëm mund të ulet dhe të ngrihet. Cilindri ulet poshtë kur materiali është me trashësi më të madhe, në të cilin rast thika që kryen largimin e tepërt të materialit aktivizohet, dhe ngrihet kur trashësia e materialit është më e hollë, këtu largon një sasi të vogël të materialit.

Hollimi sipërfaqësor kryhet gjithmonë në pjesën e prapme të materialit, dhe trashësia kontrollohet me ndihmën e mikrometrit, në të njëjtin vend pune, menjëherë pas hollimit. Rrafshimi i sipërfaqes është treguar në figurën 11.




Figura 11. Rrafshim sipërfaqësor

Pyetjet:

- Cila pjesë e lëkurës është më e mirë për gjon?
- Si ndahet lëkura për gjon sipas qëllimit?
- Çfarë materialesh përdoren si zëvendësues?
- Prej çka përfitohet lëkura e regjeneruar?
- Cilat janë dy lloje të lëkurës së regjeneruar?
- Cilat materiale janë materialet e celulozës?
- Çfarë mund të jetë materiali rrëshinor-vozë?
- Në materialet pllakë gome bëjnë pjesë:
- Cilat janë materialet jopllakë prej gome?
- Cilat materiale plastike përdoren për thembra dhe gjone?
- Cilat makina përdoren për prerjen e pjesëve të poshtme?
- Si mund të jenë thikat për prerje?
- Cilat kushte duhet të plotësohen për prerjen e pjesëve të poshtme?
- Cilat metoda zbatohen për prerjen e pjesëve të poshtme?
- Sistem njëkahësh quhet kur:
- Sistem me kahje të kundërt quhet kur:
- Në çfarë rasti zbatohet sistemi i prerjes diagonale?
- Ku janë të vendosura materialet për pjesët e poshtme?
- Në çfarë baze bëhet marrja e materialit për pjesët e poshtme?
- Në çka duhet t'i kushtojë punëtori vëmendje kur pranohet materiali?
- Cilat janë detyrat e punëtorit - këpucëtarit?
- Cilat janë detyrat e menaxherit të repartit për pjesët e poshtme?
- Si zbatohet nënvizimi?
- Në cilat raste kryhet rrafshim i sipërfaqes?
- Si kryhet hollimi i sipërfaqes?

TEMA 2. PËRPUNIMI I PRODUKTEVE TABANICË

2.1. Llojet dhe roli i produkteve tabanicë

Te lloje të ndryshme të këpucëve përdoren lloje të ndryshme të produkteve të tabanicës. Varësisht nga lloji dhe konstruktimi i këpucëve prodhohen produkte tabanicë, për:


- këpucë të mbyllura me takë të ulët,
- këpucë të mbyllura me takë të lartë,
- këpucë të çelura,
- këpucë me qepje ram,
- lloje të tjera të këpucëve.

Produktet tabanicë prodhohen kryesisht si ngjitëse-bashkuese për shkak se përmbajnë më shumë pjesë, ose në mes ngjitëse që përmbajnë 2-3 pjesë. Në të gjitha rastet, produktet tabanicë kanë për detyrë që të mundësojnë: lidhjen e pjesëve me pjesët e poshtme për të siguruar mbështetje në këmbë dhe që të sigurojë një mikroklimë të favorshme për këmbën.

Dallimet në konstruktimin e produkteve të tabanicës janë për shkak të dallimeve dhe numrit të pjesëve që përmbajnë produktet e tabanicës, dhe pastaj për shkak të ndryshimit dhe vetive të materialeve që përpunohen pjesë të veçanta.

2.1.1 Produktet tabanicë për këpucë të mbyllura me takë të ulët

Produktet e tabanicës për këpucë të mbyllura me takë të ulët janë të përbëra nga tabani dhe ngjitësja me metal të përforcuar. Përforcuesi i takës përfitohet prej ngjitëses me trashësi 2mm dhe vendoset nga thembra kah pjesa e përparme dhe e kalon gjysmën e gjatësisë së tabanicës. Për të përfituar këtë lloj produkti është patjetër të përpunohet tabanica dhe pastaj ngjitësja me metal të përforcuar. Tabanicës dhe përforcuesit duhet t'u kryhen këto operacione:



Me përpunimin e skajeve në pjesën e thembrës, grithjen e tabanicës, bëhet kontroll dhe shpërndarje.

Prerja dhe rrafshimi i sipërfaqes janë operacione të përshkruara më parë.

Grithja kryhet me një letër grithëse me numeracion-100 (100 ruaza në 1 cm), me qëllim për t'u hequr shtresa e sipërfaqes për rrjedhje më të mirë të djersës që krijohet, për bartjen e këpucëve.

Hollimi i skajeve të përforcuesit të thembrës kryhet në pjesën e përparme me gjerësi 12 mm, dhe kjo mund të bëhet edhe anash (Fig. 12).




Figura 12. Ngjitëse me përforcim metalik

- hapja e kanalit (duke krijuar një vrimë) në pjesën e takës, përforcim me ngjitësen,
- vendosja e përforcimit metalik,
- përforcimi i tyre mes veti.

Formësimi i pjesëve të bashkuara të produkteve të tabanicës kryhet në mënyrë që të marrin formë pjesët e tabanit në kallëp (Figura 12). Kryhet në presë nën presion të caktuar.

Përpunimi i skajeve të thembrës kryhet me grithje, në grithje të thjeshtë apo automatike.

Me kontrollimin e kualitetit të produkteve të tabanicës, përcaktohen produkte të majta dhe të djathta.

2.1.2. Prodhime të tabanicës për këpucë të mbyllura me takë të lartë

Procesi teknologjik për prodhimin e produkteve të tabanicës për këpucë të mbyllura me takë të lartë, është pothuajse i njëjtë me procedurën për përfitimin e produkteve të tabanicës për këpucë me takë të ulët, me pak ndryshim. Ky ndryshim përbëhet në:

- përforcimin metalik në pjesën e thembrës që është në formë të pirunit,
- në pjesën e thembrës që ka një pllakë metalike,
- përforcuesi metalik që ka lakim të madh.

Përforcimi metalik në formë piruni duhet të jetë vendosur drejtë, ose me vidë që është bërë fiksimi. Taka-thembra duhet të kalojë nëpër zonën në formë

piruni në përforcuesin metalik. Përndryshe, do të jetë takë e paqëndrueshme dhe mund të vijë te dëmtimi i përforcuesit me ngjitësen dhe të ngjajshme. Nëse është e nevojshme, të vendoset një pllakë metalike në pjesën e thembrës, e cila ka për detyrë për të parandaluar depërtimin e vidës përmes përforcuesit dhe kështu që të mos vijë deri te dëmtimi.

Madhësia e kthesës së takes varet nga lartësia e takës thembër. Për shembull, nëse lartësia e takës shumë e madhe, përforcuesi i metalit kthesën do ta ketë më të madhe dhe anasjelltas. Në rast se lartësia e takës nuk përputhet me madhësinë e kthesës, do të vijë në mënyrë të parregullt baraspeshë e trupit të njeriut, dhe kështu vijnë deri te lodhje të parakohshme e këmbës dhe këpucë do të jetë jo stabile për bartje. Ngjitëse me përforcues të metalit për këpucë të mbyllura me takë të lartë, është e paraqitur në figurën 13.




Figura 13. Ngjitës me përforcues të metalit për këpucë të mbyllura me takë të lartë

2.1.3 Produktet e tabanicë për këpucë të hapur

Produkte e tabanicë për këpucë të hapur (sandale)përpunohen në të njëjtin proces teknologjik si dhe produktet e këpucë të mbyllura, në pavarësisht se çfarë këpucë prodhohet me takë të ulët apo të lartë.

Nëse **këpucët e hapura janë me takë të ulët**, radhitja e operacioneve është e njëjtë si te produktet e tabanicës për këpucë të mbyllura me takë të ulët, ose te **përpunimi i produkteve për këpucë të hapur me takë të lartë**, radhitja e

operacioneve është e njëjtë si te produktet e mbyllura te këpucët me takë të lartë. Dallimi është vetëm në operacionet plotësuese që janë kryer vetëm te këpucë të hapura. Këto operacione janë:

- Shënimi i vendit për të vendosur shiritat në sandale
- Hapja e birave për rripin në sandale
- Vendosja e shirit në skajet e thembrave.

Shënimi i vendit për të vendosur shiritat në sandale bëhet duke i përdorur shabllonet dhe një laps ose stilolaps për të shënuar.

Hapja e vendeve për vendosjen e rripave në sandale, gjatë bashkimit të pjesëve të poshtme me pjesët e sipërme, kryhet me grithje me anë të dorës ose grithje me makinë. Hapja e vendeve kryhet me dorë ose me makina, makinat që përdoren janë me teh të lëvizshëm dhe gjatë lëvizjes bëjnë prerjen, kurse gjysmëprodhimet tabanicë janë vendosur në pozicion pjerrtas dhe ky pozicion ngel edhe gjatë punës. Me këtë hapje (prerje) rritet cilësia e ngjitjes së pjesëve të sipërme dhe të poshtme, duke e rritur produktivitetin e punës.

Në lloje të caktuara të produkteve, këpucë të hapura me takë të ulët, prerja e vendeve të rripave mund të zëvendësohet me një tjetër strukturë, për shembull, prodhimi tabanicë të ketë përmbajtje në përforcuesin e thembrës, dhe në atë të ketë prerës të ngjitur në pjesën e sipërme.

Prerje për rripa në sandale, heqja e skajeve të sandales




Figura 14. Tabanicë për këpucë të çelura

Vendosja e trakës në skajet e tabanëve mund të bëhet në të gjithë hapësirën ose vetëm në vendin ku është e hapur, pjesën e sprasme ose vetëm në pjesën e përparme. Heqja mund të kryhet:

- Me dorë-në mënyrë manuale,
- Me makinë.

Heqja **me dorë** bëhet me trakë të përgatitur më parë të ngjitur në skajet tabanicë. Ajo fillon në zonën e këmbëve, kyçin e këmbës dhe përfundon në të njëjtin vend.

Heqja **me makinë** konsiston në respektimin e tabanicës që transportohet dhe gjatë transportit që është e ngjitur më parë në makinë. Figura 14 tregon pamjen e produktit tabanicë për këpucë të hapura.

2.1.4 Prodhimet tabanicë për këpucë me kuadrate

Prodhimet tabanicë për këpucë me kuadrate janë të ndryshme nga llojet e tjera të produkteve tabanicë duke pasur element të veçantë, të quajtur lipna ose **papuçe fryrje**. Kjo do të thotë se ky lloj produkti është më element ndërtimi të veçantë. Lipna lejon ngjitjen e pjesës së parme dhe të pjesës së prapme–thembrës nga anët e kornizës. E njëjta është e vendosur vetëm në pjesën e parme, ndërsa në pjesë të thembrës nuk ekziston. Vendosen në distancë të caktuar nga skajet e tabanicës. Për shembull: në pjesën e jashtme është e vendosur në distancë prej 6 mm, në pjesën parme 6-8 mm dhe anën e brendshme, larg nga skajet, 8-12 mm. Kjo distancë është më e madhe për shkak se ka një shumë më të madhe të materialeve prandaj duhet të vendosen gjatë ngjitjes të pjesës së sipërme me tabanicë.

Ky lloj i produkteve tabanicë mund të prodhohet në dy mënyra:

- klasike,
- jo klasike.

Mënyra klasike (fryrje e tabanicës) forma e tabanicës është krijuar nga prerja me shabllon, në mënyrë që materiali është bërë në formë të konstruktimit dhe kjo duhet të jetë e cilësisë më të mirë. Prerja mund të bëhet nga një ose të dy palët, ku skajet hiqen dhe krijohen shtresa. Me krijimin e kësaj lipne kasetë ngjitet vetëm lipna ose e mbulon tabanicën-pjesën e sipërme me tabanicë.

Mënyra jo klasike e tabanicës mund të pritët prej materiali me kualitet më të dobët dhe për lipna përdoret trakë e veçantë e përbërë prej lëkurës së rigjeneruar, e mbuluar me material tekstili. Operacionet që duhet të bëhen me këtë lloj janë:

prerja e tabanicës, grithja, ngjitja, bashkimi lentë, bashkëngjitja me përforcimin e thembrës. Ky lloj produkti tabanicë është treguar në Fig 15.




Figura 15. Tabanicë në kuadrat për këpucë të qepura

2.1.5 Produktet tabanicës për llojet tjera të këpucëve

Llojet tjera të produkteve tabanicë prodhohen në mënyra të veçanta, varësisht prej qëllimit të përdorimit të tyre. Në tabanicat e tilla me strukturë të veçantë bëjnë pjesë: këpucët fleksibile, këpucët me qepje dhe këpucët e spërkatura.

2.1.5.1 Tabanica për këpucë fleksibile verore

Tabanicat për këpucë fleksibile verore kanë shtep (të qepura) në të gjitha vëllimet dhe gjatë rripit. Janë më të gjera se kallëpi. Mjaft janë fleksibile. Përpunimi përbëhet nga: prerja e tabanicës, me bira për rripa, qepje shtep dekorative, kontrolli dhe shpërndarja e tabanicës së majtë dhe të djathtë. Kontrolli i cilësisë, kontrolli i përgatitjes dhe kontrolli i përpunimit. Ky lloj i tabanicës është e treguar në Fig 16.




Figura 16. Tabanicë fleksibile e këpucëve për verë

2.1.5.2 Tabanicë për këpucë me qepje

Këto tabanica duhet të përpunohen prej materialeve të buta që qepja të jetë kualitative. Shumica e pjesëve të prera prej skajeve të lëkurës „cepanik” përpunohen sipas procedurës së mëposhtme: Prerja, rrafshimi i sipërfaqes, përforcimi dhe grithja. Nëse përpunohet më tepër shtresa, duhet të përgatiten dhe të ngjiten shtresat.

2.1.5.3 Tabanica për këpucë të hapur me gjon të stërkatur

Në këtë lloj të mbathjeve, tabanica pritët prej teksoni dhe ka një formë të veçantë që është treguar në Figurën 17. Ky lloj i tabanicës ka disa prerje që aplikohen për të tërhequr pjesën e sipërme. Këto prerje janë në gjerësinë e kallëpit. Pjesët e lëshuara kanë një gjerësi më të madhe prej kallëpit pasi janë përpunuar skajet dhe pason spërkatja e masës në gjon, foto 17.




Figura 17. Tabanicë për këpucë të spërkatura

2.1.5.4 Tabanica për këpucë me lëkurë të kthyer-antilop

Te lëkura e kthyer dhe fleksibile, këpucë me përbërës të pjesës së sipërme dhe thembër në pjesë, përdoret tabanica me konstruktim të veçantë e cila është e prodhuar me ngjitëse. Procesi zhvillohet si vijon më poshtë:

- prerja gjysmëtabanicë,
- hollimi anësor në pjesën e përparme, në gjerësi prej 10-12 mm,
- bashkëngjitja e përforcuesit metalik,
- kontrolli i gjysmëtabanicës,
- shpërndarja e majtë dhe e djathtë e gjysmëprodhimit.

Ky lloj i gjysmëtabanit prodhohet për dy numra, dhe krehja kryhet vetëm në pjesën e thembrës dhe pjesën e përparme është e përbërë prej materialit nga i cili është bërë pjesa e sipërme. Te këpucët fleksibile tërhiqet vetëm një pjesë e këpucës, që do të thotë se pjesa e sipërme duhet të ndahet në mes.

Pyetjet:

- Në çfarë lloji të produkteve prodhohet tabanica?
- Sipas llojit dhe konstruktimit të këpucëve ekzistojnë këto lloje të tabanicës:
- Prej çka përbëhen produktet e tabanicës për këpucë të mbyllura me takë të ulët?
- Cilat operacione janë të nevojshme për tabanica?
- Cilat operacione janë të nevojshme për prodhimin e tabanicës me përforcim metalik?
- Me çfarë vërtetohet kontrollimi i prodhimeve tabanicë?
Tharja e gjysmëprodhimit ka për qëllim për të hequr avullin e tretësit në të cilin është i shpërndarë në ngjitës, që është i bartur në pjesët e këpucës, thembrës tabanicë etj. dhe lagështi të tepërt që është në materiale. Gjatë tharjes, lëkura

bëhet më e qëndrueshme për ta mbajtur formën që e ka përfituar gjatë procesit të formësimit.

Tharja mund të bëhet me:

- tharje natyrore,
- tharje artificiale.

Mënyra e tharjes natyrore kryhet duke lëvizur gjysmëprodhimin nga njëri në tjetrin operacion teknologjik. Megjithatë, kjo tharje nuk është e mjaftueshme dhe është shumë e ngadalshme, dhe për atë bëhet edhe tharje artificiale.

Tharja artificiale - kryhet para se të ngjitet gjoni me tabanicën. I njëjti operacion kryhet si linjë e fundit e paratërheqjes ose para kthimit të skajeve gjatë ngjitjes. Kjo kryhet në temperaturë prej rreth 100 °C, dhe nëse sandalja T mund të jetë më e madhe, ose te modelet tjera ku ajo ka nevojë që plotësisht të stabilizohet formësimi i kallëpit.

Tharja kryhet në tharëse të veçanta me trakë transportuese. Ajo është e pajisur me ngrohje nga ajri i ngrohtë, dhe në raste të nevojshme mund të bëhet lagjia e ajrit.

Tharja mund të kryhet në mënyrë që të vendoset gjysmëprodhimi vendoset në trakë dhe kalon nëpër tharëse, dhe në fund të shiritit gjysmëprodhimi del i thatë (figura 43). Pas kësaj bëhet kontrolli i formësimit të pjesëve përbërëse, shtrëngimi dhe pamja e gjysmëprodhimit si një tërësi, dhe nëse produktet e nevojshme kthehen përsëri në ri-tharje. Megjithatë, zgjidhja e saktë është rregullimi i duhur i T së tharjes, shkalla e lagështisë dhe shpejtësia e lëvizjes së shiritit. Të gjitha kushtet e përcaktuara më parë varen nga lloji dhe projektimi i këpucëve.

Tharja është shumë e rëndësishme për operacione të caktuara të mëvonshme:

- për grithjen e lëshimit të pjesës së sipërme e cila bëhet te të gjitha llojet e këpucëve, mesqjonit dhe pjesëve të ngjitura me ngjitës.
- për heqjen e kallëpit nga gjysmëprodhimi që kryhet te të gjitha llojet e këpucëve që janë me qepje dhe të ndryshme etj.

Me tharjen e gjysmëprodhimit largohen edhe rrudhjet në fytyrën e lëkurës, dhe në mënyrën e tërheqjes, për shkak se lëkura është e ngrohtë, ndërsa ndodhet gjysmëprodhimi të jetë kualitativ në tërësi te të gjitha këpucët.

Procesi i tharjes është i rëndësishëm që këpucët të kenë cilësi të mirë në përgjithësi.



gjysmëprodhim në fillim të tharjes



gjysmëprodhim në fund të tharjes

Figura 43.

5.10 Grithja e lëshimeve tërheqëse

Te gjysmëprodhimi i tërhequr ku janë larguar rrudhat, bëhet hekurosja e pjesës së thembrës dhe tharja, bëhet grithja e lëshimeve tërheqëse atëherë kur është e nevojshme. Ky operacion, në shumë ndërmarrje për përpunimin e këpucëve kryhet në grithëse të thjeshtë, me ndihmën e shiritit grithës ose me unazë metali, dhe mund edhe me makinë automatike.

Grithja e vendeve të rrudhura gjatë tërheqjes bëhet për të hequr shtresën e sipërfaqes e cila përbëhet nga shtresa të ndryshme që nuk lejojnë të depërtojnë ngjitës në materiale dhe të lidhen me indin e lëkurës. Gjithashtu, me grithje rritet efekti i ngjitjes në sipërfaqe.

Operacioni i grithjes duhet **të kryhet me kujdes**, ajo do të thotë mos të largohet sasia e tepërt ose sasi e vogël e materialeve prej asaj sa që duhet, të mos të dëmtohet gjysmëprodhimi. Prandaj, te procesi i grithjes duhet të adaptohet shtypja e materialit te gjysmëprodhimi dhe shpejtësia e lëvizjes së gjysëmprodhimit gjatë grithjes.

Në praktikë, grithja kryhet në dy vende pune dhe veç e veç në pjesën e përparme dhe veçmas në pjesën e thembrës. Në pjesën e përparme grithja kryhet me shirit grithës, kurse në pjesën e thembrës, me një unazë gome dhe tel prej metali, në realitet lëshim që është i varur nga ngjitësi, të gjitha grithjet kryhen me shirit grithës, kurse tërheqja zhvillohet me thumba-gozhda, grithja kryhet me unaza gome dhe tel metali.

Gjatë grithjes me tel prej metali, bën ngritjen e fibrave të lëkurës, që rrit efektin e sipërfaqes ngjitëse. Në pjesën e përparme grithja kryhet me shirit, fibrat e lëkurës nuk ngrihen, por e largon shtresën sipërfaqësore nga materiali. Megjithatë, ka raste ku përdoret vetëm unazë gome me një tel metalik dhe grithja kryhet në vend pune.

Kur punohet në dy vende pune, fillohet nga pjesa e nyjes së këmbës, dhe kryhet grithja e pjesës së përparme, së pari nga njëra anë pastaj nga tjetra, dhe pastaj nga pjesa e thembrës , njëjt njëherë nga njëra anë pastaj nga tjetra.

Kur punohet në një vend pune, fillohet në pjesën e përparme, dhe kryhet grithja e pjesës së thembrës nga njëra anë pastaj nga tjetra.

Në të dy rastet, gjysmëprodhimi mbahet me dorë nga njëra anë e pjesës së përparme, kurse me dorën tjetër nga thembra (shih figurën 44). Gjatë grithjes shtypet materiali pa ndërprerë dhe vazhdimisht, në lëvizjet më të gjata, dhe pastaj gjysmëprodhimi pastrohet nga pluhuri dhe kontrollon operacioni përfundimtar.

Gjatë grithjes automatike fillohet në pjesën e përparme, dhe grithet drejt pjesës së thembrës nga njëra në anën tjetër.



Figura 44. Grithje në lëshimet tërheqëse

5.11 Përforcimi i thembrës dhe pjesës së përparme

Pas mbarimit të tërheqjes të pjesës së sipërme dhe tabanicës, paraqitet një zbrazëti në mes të pjesës së sipërme dhe tabanicës. Ky lëshim duhet të plotësohet për të mundësuar një rënie të mirë në mes të pjesëve të këpucëve. Në pjesën e thembrës i jepet një shtesë me trashësi më të madhe, sepse këtu është hapësira, dhe në pjesën e përparme përforcohet me trashësi më të vogël.

Pas përforcimit të pjesës së përparme dhe thembrës **fitohet gjysmëprodhim**, i cili është i gatshëm për bashkëngjitje me pjesët tjera të poshtme. Figura 45 tregon paraqitjen e gjysmëprodhimit pas shtimit të përforcimit në pjesën e përparme dhe thembrës.




Figura 45. Përforcimi i thembrës dhe pjesës së përparme

Pyetjet:

- Në sa grupe janë ndarë operacionet për përfitimin e prodhimit ngjitës?
- Në sa faza bëhet bashkëngjitja e pjesëve të sipërme dhe pjesëve të poshtme?
- Cila është radhitja e përgjithshme e operacioneve të paratërheqjes?
- Si bëhet përforcimi i tabanicës dhe kallëpit (fiksimit)?
- Cila është shpërndarja e kallëpeve dhe tabanicës?
- Si bëhet ngjitja e përhershme e pjesëve të këpucëve?
- Çka është thumbimi (heftimi)?
- Çfarë është paratërheqja pa tërheqje të majës?
- Çfarë është paratërheqja me tërheqje të majës?
- Cilat mjete përdoren për tërheqje dhe paratërheqje?
- Si zhvillohet krehja e majës?
- Çka duhet të bëhet para se të tërhiqet pjesa e sipërme dhe anësore me ngjitës?
- Si kryhet thumbimi gjatë tërheqjes anësore?
- Me sa thumba bëhet tërheqja anësore?
- Si bëhet tërheqja e thembrës?
- Prej çka varet numri i gozhdëve gjatë tërheqjes së thembrës?
- Çfarë përfitojmë me tërheqjen e thembrës me gozhda-thumbat?
- Çfarë operacionesh përdoren për tërheqjen e gjysmëprodhimit?
- Çfarë arrihet me tharjen e gjysmëprodhimit?
- Çfarë është grithja?
- Te cilat lloje të këpucëve kryhet grithja?
- Si përfitohet gjysmëprodhimi?

TEMA 6. NGJITJA E PJESËVE TË SIPËRME ME PJESËT E POSHTME

6.1 Mënyrat e ngjitjes

Ngjita e gjonit me me gjysmëprodhimin e përfituar më parë mund të bëhet në mënyra të ndryshme që varet nga konstruktimi, lloji dhe qëllimi i këpucës. Ngjitja e gjysmëprodhimit të tërhequr dhe gjonit zhvillohet me thumbim te këpucët e llojit të këtitillë, te këpucët me qepje dhe te lloji i kombinuar me qepje dhe thumbim. Qepja anësore shfrytëzohet te këpucët me qepje, me kuadrate, fleksibile, qepje të përpunuara me dorë në gojzer-këpucë të qepura, te këpucët me ngjitje „Kalifornia” dhe këpucë të tjera. Gjoni i shtypur përfitohet me vullkanizim dhe spërkatje dhe kështu përfitohen këpucët me gjon të spërkatur. Nga pamja e mësipërme mund të shohim se përbërja e gjonit dhe gjysmëprodhimit të bëhet me: qepje, thumbim, qepje anësore, ngjitje, spërkatje dhe vullkanizim.

6.1.1 Ngjitja me thumbim-gozhdim

Ngjitja me thumbim është një ndër mënyrat më të vjetra të ngjitjes edhe sot përdoret por shumë pak. Kjo kryhet me thumba druri apo flokë që janë të prera nga një trakë prej druri. Thumbimi zhvillohet në makinën e quajtur flokovka, dhe nga ky operacion quhet flokuvanje.

Flokovka përbëhet nga:

- mbajtësi i poshtëm (kllapa)
- Funerë (shillo)

Në mbajtësen **e poshtme** gjenden:

- tak druri ose floku
- mekanizëm për prerje të drurit
- mekanizëm për thumbim

Funeri e shpon gjysmëprodhimin në dy faza, por punon në katër faza.

Gjysmëprodhimi pa kallëp vendoset në mbajtësin e poshtëm. Funeri (shillo) pjesërisht kalon nëpër gjysmëprodhim, kështu lëviz në distancë prej dy shpimeve,

pastaj funeri krejtësisht kalon në material dhe në fund kthehet në pozitën e mëparshme. Në këtë moment aktivizohet mekanizmi për prerjen e tyre, dhe mekanizmi i goditjes me çekan, thumbim. Gjatë punës gjysmëprodhimi gjithë kohën lëviz rreth mbajtësit të makinës dhe i thumbon thumbat në një rresht.

Te thumbimi me gozhda fillon në lakun e brendshëm në të dy produktet. Te gjysmëprodhimi i majtë, thumbimi fillon në pjesën e përparme dhe pastaj në pjesën e thembrës dhe përfundon në pikën e fillimit. Te gjysmëprodhimi i djathtë, thumbimi bëhet pra në pjesën e thembrës dhe pastaj pjesa e përparme dhe përsëri në të njëjtin vend (shih figurën 46).




Figura 46 Vendi i fillimit dhe drejtimi i thumbimit i produkteve të majta dhe të djathta

6.1.2 Ngjitja me qepje

Qepja është prej mënyrave për ngjitjen e gjysmëprodhimit tërheqës të pjesëve të poshtme të gjonit, në qoftë se këpucët përmbajnë mesgjon. Kjo ngjitje kryhet me makinë të quajtur makina qepëse (proshivalka), e përbërë nga mbajtësi i poshtëm.


Makina për qepje ka një funeri (shillo) por ka një gjilpërë të drejtë që ka rol të dyfishtë: për të krijuar hapje dhe krijon shtep. Gjilpëra punon në tri faza:

- e shpon materialin
- së bashku me gjysmëprodhimin lëviz për dy shpime

- së fundi, tërhiqet nga materiali, merr fijen e perit dhe e gërsheton me fijen në drugëz, dhe kështu krijon shtep me dy penj.

Qepja bëhet në atë mënyrë që gjysmëprodhimi pa kallëp vendoset në mbajtësin e poshtëm, skajet e sipërme të gjonit lëvizin në udhëzues të veçantë. Me shtypjen e nënkëmbëzës makina fillon të punojë. Gjilpëra lëshohet, kalon nëpër material dhe vjen në mbajtësin e poshtëm i cili është një element i veçantë, d.m.th., mekanizmi në formë ylli me dy hapje, të mesme, përmes të cilit kalon gjilpëra me perin. Gjilpëra ndalon në pozitën e poshtme, pastaj kthehet dhe gjatë lëvizjes lartë, e merr fijen e perit, ai kalon nëpër materiale në pozicionin e sipërm dhe bën thurjen që është në drugëz.

Marrja dhe dorëzimi i perit është i sinkronizuar me rrotullimin e yllit dhëmbëzor që ndodhet në pjesën e poshtme të përforcuesit. Ky yll që lëviz vazhdimisht për 360°, kështu që vrima periferike, dhe fija që kalon nëpër atë, ndryshon qëndrimin e saj. Lëvizja dhëmbëzore e yllit përafërsisht përputhet me tri faza që kryejnë gjilpërat. Për shembull, kur gjilpëra kryen fazën e parë, hapja (vrima) periferike është e pozicionuar në pozitën 2, në momentin e marrjes, dhënies dhe gërshetimit të perit, hapja periferike është në pozitën 3 (shih foton 47).



Që lëvizja të jetë e sinkronizuar në hapësirën periferike të gjilpërës dhe dhëmbëzori në formë të yllit është e nevojshme përpara se të fillojë me qepjen e njëjta duhet të përshtatet.

Te produktet e majta fillon te lakimi në pjesën e brendshme, dhe qep përreth pjesën e përparme dhe pjesën e thembrës dhe përfundon në pikën e fillimit. Në këtë rast dora e djathtë ka pozitën fillestare në "0" dhe me dorën e majtë mbulon

pjesën e thembrës. Me këtë princip qepet në pozicionin 1, dhe atëherë të dy duart lëvizin në drejtimin që është treguar në foto, dhe qepja kryhet në pozitën 2-3-4.

Pozicioni i gjysmëprodhimit gjatë qepjes shpjegohet në makinë, në ndërmarrjen për përpunimin e këpucëve.

Për qepje cilësore, duhet të zgjidhet trashësia e duhur e:

- gjilpërës, dhe
- perit.

Trashësia e gjilpërës është shprehur në numra. Hapësira (vrime) e gjilpërës duhet gjithmonë të jetë më e madhe se trashësia e perit, të jetë në gjendje për të lëvizur lirisht në vrimë.




Figura 48. Vendi i fillimit dhe drejtimi (kahja) i qepjes

6.1.3 Ngjitja me qepje anësore

Me qepje anësore ose dublim „doplvanje” bëhet ngjitja e lëshimeve dhe dështimeve ose dështimet e këpucëve fleksibile të qepura, me pjesën e sipërme dhe mesgjonit - këpucë me qepje, me gojzer, pjesë e sipërme dhe mesgjon - këpucë të qepura, e cila varet nga lloji dhe konstruktimi i këpucëve. Në të gjitha rastet, qepje anësore bëhet me makinë me përforsues anësor, e cilat në industrinë e përpunimit të këpucëve quhet „doplerka”, kështu që operacioni është quajtur doplvanje.

Makina për qepje anësore përbëhet nga:

- Funerë S (shillo)
- Gjilpërë e lakuar.

Funeri lëviz nga lartë poshtë, kalon nëpër materiale, pastaj zhvendoset në një distancë prej dy shpimeve, së bashku me gjysmëprodhimin kthehet në pozitën e saj fillestare nëpërmjet hapjes së bërë nga gjilpëra, kalon dhe vjen në pozitën e mëposhtme. Në këtë moment, pavarësisht nga lëvizja e gjilpërës bën tërheqjen e perit që mban gjilpëra, dhe kthehet në pozitën e saj fillestare. Në pozitën e lartë, së bashku me fijen që është në drugëz kryen gërshetimin.

Në qepjen anësore, gjysmëprodhimi vendoset në funksion me gjonin në mbajtësin anësor që është i përforcuar në mbajtësin e sipërm.

Qepja fillon me shtypjen e nënkëmbëzës dhe zhvillohet në të njëjtën mënyrë si te këpucët me qepje. Kjo do të thotë që fillon në zonën e kyçit të këmbës, te gjysmëprodhimi i majtë, qepet pjesa e përparme dhe përfundon në të njëjtin vend. Te gjysmëprodhimi i djathtë qepja fillon në zonën e kyçit të këmbës dhe qepet rreth thembrës, pastaj në pjesën e përparme dhe përfundon në të njëjtin vend (fig. 49). Nëse qepja kryhet vetëm në pjesën e përparme, atëherë vendi i fillimit dhe mbarimit ndryshon. Për shembull, te gjysmëprodhimi i majtë fillohet te lakimi i brendshëm, kurse te i djathti në këndin e jashtëm dhe qepet në të gjithë gjatësinë, me përjashtim të pjesës së thembrës (fig. 49).




Figura 49. Ngjitja me qepje anësore

6.1.4 Ngjitja (bashkimi) me ngjitës

Ngjitja e gjysmëprodhimit të tërhequr dhe gjonit me ngjitës, sot më së shumti zbatohet, megjithatë, dhe ankesat më të mëdha janë te këpucët me ngjitje.

Cilësia i këpucëve me ngjitje varet prej llojit të materialit ngjitës dhe mënyrës së përpunimit. Prej ngjitëseve që përdoren janë:

- Ngjitës dy-komponentësh poliuretani që përdoret për të gjitha llojet e gjoneve
- Ngjitës dy-komponentësh poliklori për gjon prej lëkure, mënyra për ngjitjen e gjonit me ngjitës me pjesën e tërhequr më parë dhe mund të ndahet në tri faza:

Përgatitja e ngjitësit për punë. Për ngjitjen e gjonit me ngjitës përdoren ngjitëse dy-komponentësh. Përgatitja e ngjitësit përbëhet me dhënien e elementit të dytë. Si komponent i dytë është desmodur 5-8 %, pastaj përzierje e mirë, qëndron 10-15 minuta dhe bartet në gjon me furçë-brushë.

Përgatitja e gjoneve për ngjitje varet nga lloji i materialit që janë të përpunuar gjonet.

Nëse gjoni është bërë nga:

- polivinilkloridi (PVC), së pari lahet me preparate speciale të caktuara për këtë lloj material dhe pastaj bëhet ngjitja.
- poliuretani (PU), së pari bëhet grithja dhe pastaj bëhet ngjitja, ku përfitohet cilësi më e mirë e ngjitjes.
- gjonet prej gomës së pari grithen, pastaj bartet preparati që përmban klor aktiv, i cili e bymeh (përgatitje) dhe e ngjet sipërfaqen.

Përgatitja e pjesës së sipërme për ngjitje me ngjitës përbëhet nga:

- grithja e lëshimit tërheqës që zhvillohet në mënyrën e përshkruar më parë
- bartja e ngjitësit në gjysmëprodhim tabanicë dhe gjon
- tharja e ngjitësit me ajër

Bartja e ngjitësit kryhet dy herë. Pas bartjes së parë, tharja e ngjitësit mund të kryhet në mënyrë natyrore ose artificiale, dhe pas bartjes së dytë, tharja e ngjitësit bëhet në mënyrë natyrore.

Pas kryerjs të punëve më parë-kryhen:

- riaktivizimi i ngjitësit
- adaptimi i gjonit dhe gjysmëprodhimit.

Riaktivizimi i ngjitësit bëhet para se të ngjitet dhe bëhet presimi. Riaktivizimi përbëhet në nxemjen e gjysmëprodhimit në aparatet e ngrohjes në $T 50 - 80\text{ }^{\circ}\text{C}$ ose në një aparat infra të kuq rreth 10 sekonda. Nëse bëhet fjalë për infra të kuq, pastaj kryen zbutjen e materialit, që përdoret te neolit gjone.

Adaptimi i gjonit me gjysmëprodhim bëhet nga pjesa e përparme deri te pjesa e thembrës. Nëse bëhet gjoni me thembrën, atëherë rregullimi fillon prej thembrës kah pjesa e përparme e këpucës.

Pas rregullimit manual (me dorë) dhe ngjitës të përkohshëm, bëhet presimi në makinë me dy kallëpe:

- kallëpi i poshtëm
- kallëpi i sipërm

Kallëpi i poshtëm e ka formën e tabanicës të gjysmëprodhimit.

Kallëpi i sipërm përbëhet nga përforcues që mund të jenë:

- të shkurtër, për këpucë të ulëta
- të gjatë, për këpucë të larta dhe çizme.

Ngjitja e gjonit me pjesën e sipërme me ngjitës është e treguar në foto 50



Figura 50. Ngjitja- bashkimi i gjonit me gjysmëprodhimin me ngjitës

6.1.5 Ngjitja me spërkatje (shpric-stërpikje)

Spërkatja është proces i zbutjes së plastikës, formësimin e masës së plastikës në formë të gjonit dhe ngjitjen e gjysmëprodhimit të përfituar më parë. Ajo është përdorur si mënyrë për të ngjitur gjysmëprodhimin me gjonin -te këpucët e lehta për përdorim të përditshëm, këpucët sportive dhe llojet tjera të këpucëve. Në të gjitha këto raste gjoni është formuar dhe i përbërë me spërkatje, për dallim nga ato llojet e këpucëve ku gjoni spërkatet dhe më pas ngjitet në gjysmëprodhim.

Për ngjitje me spërkatje sot përdoren PVC dhe PU, dhe për këtë arsye dallohen këpucë PVC dhe këpucë me PU. Megjithatë, principi i punës është i ngjashëm.

Masa plastike në formën e granulave, ajo zbutet dhe shkrihet në T, pastaj përmes transportuesit në formën e kërmillit transferohet në vrimë për spërkatje dhe shtypet në kallëpe në formë të caktuar, e cila çon në kallëp dhe tërhiqet në gjysmëprodhim. Gjatë transportit në masë plastike ngrohet me ngrohës që janë të radhitur në pjesën e jashtme të cilindrave transportues në formë kërmilli. Në këtë mënyrë sigurohet ngrohje shtesë dhe barazimi i masës plastike, deri në momentin e spërkatjes.

Spërkatja vazhdimisht përsëritet, në mënyrë që qelia lëviz vazhdimisht dhe vjen në momentin e spërkatjes. Ky proces e rrit produktivitetin e punës.

Spërkatja është e automatizuar. Kur kallëpi i poshtëm do të mbushet me tepricë të masës plastike shkon në kanalet kthyese dhe spërkatja automatikisht ndërpritet.

Intervali i spërkatjes si dhe parametrat tjerë janë të rregulluara në tabelën komanduese.

Në industrinë për përpunimin e këpucëve ka dy mënyra të spërkatjes: kur gjoni është ngritur afër pjesës së sipërme të këpucëve, dhe kur spërkatja kryhet me dy cilindra, ku spërkatet së pari njëra dhe pastaj ngjyra tjetër në masë plastike. Në foto 51 është paraqitur procesi i spërkatjes.



Figura 51. Makinë për ngjitje me spërkatje

6.1.6 Ngjitja me vullkanizim

Vullkanizimi i i fundit (gjonit) të këpucëve përfitohet me procese fiziko-kimike. Te procesi i vullkanizimit krijohen:

- Ndryshime fizike
- Ndryshime kimike

Ndryshimet fizike - përbëhen në zbutjen e masës së nxehtë, formësimin e pjesës të poshtme të këpucëve dhe ngjitjen me gjysmëprodhimin që është i vendosur në pjesën e sipërme.

Ndryshimet kimike - janë të dukshme për mbushjen e lidhjeve të dyfishta në molekulën e dizoprenot, të polymerizuara në kauçuk që janë krijuar nga sulfuri, ashtu dendësia paraqet ndryshim në përzjerjet e kompleksit.

Në kallëpin e poshtëm te makina e vullkanizimit është formuar fundi i këpucës dhe bashkëngjitet me gjysmëprodhim që është vendosur më parë në pjesën e sipërme të kallëpit vullko- presa, dhe pastaj kryhet ngjitja me vullkanizim.

Ngjitja me vullkanizim zhvillohet te dy lloje të këpucëve:

- me konstruksion të lehtë
- me konstruksion të rëndë.

Edhe te dy llojet e këpucëve, gjoni (thembra) e këpucëve është e gomës që është krijuar nga masa e vullkanizuar dhe përbëhet prej gjysmëprodhimi të tërhequr të këpucëve, për dallim të këpucëve me (thembra) gjoni prej gomës që janë të përbërë me ngjitje. Procesi i vullkanizimit zhvillohet në kushte të përcaktuara në mënyrë rigoroze, që janë:

- temperatura
- presioni-shtypja
- kohëzgjatja e vullkanizimit.

Temperatura e vullkanizimit është rreth 160 °, presioni, shtypja varet nga lloji i këpucëve dhe kohëzgjatja e vullkanizimit është prej 3 - 5 minuta. Ngjitja me vullkanizim është e treguar në figurën 52.



Figura 52. Makinë për ngjitje me vullkanizim

6.1.7 Ngjitje e këpucëve shtëpijake-vendase

Ngjitja e këtyre këpucëve kryhet ashtu që lëkura kthehet nga pjesa e brendshme e lëkurës. Kjo do të thotë pjesa e sipërme dhe e mesgjonit janë mbledhur nga ballina dhe përsëri kthehen në pjesën e mëparshme. Në këtë lloj të

mbathjeve pjesët janë të përbëra prej: fillcit, mesgjonit, gjithashtu prej fillci, kurse gjoni-thembra prej lëkurës apo prej gomës.

Procedura e përgatitjes është si vijon: gjoni dhe mesgjoni bashkohen me ngjitje.

Gjysmëprodhimit të përfituar i bashkëngjitet pjesa e sipërme prej lëkurës nga ana e kundërt (pjesa e prapme) dhe bëhet qepja.

Qepja bëhet në makinë me gjilpërë të lakuar që punon në tri faza:

- Në fazën e parë, gjilpëra kalon nëpër material pa perin dhe me lëvizje gjysmërrethore kalon nëpër mesgjon dhe pjesa e sipërme tërhiqet nga lartë në pozitën 1.
- Në fazën e dytë, gjilpëra e merr perin dhe e kthen në të njëjtën vrimë dhe kthehet në pozitën 2.
- Në fazën e tretë, materiali lëviz në një distancë prej dy shpimeve. Në këtë pikë gjilpëra ndalet, por peri tërhiqet dhe lëshohet nga gjilpëra. Mënyra e lëvizjes së gjilpërës dhe perit përsëritet, dhe kështu bëhet krijimi i vjegëzës (bëhet gërshetimi i fijos-perit). Gjilpëra me perin, me dalje nga mesgjoni kalon nëpërmes fijos së tërhequr më parë dhe me lëvizjen e gjysmëprodhimit me një distancë prej dy shpimeve, peri përsëri tërhiqet dhe bën shtrëngimin e perit të më përparmë dhe bëhet gërshetimi i perit.

Kur qepja e gjysmëprodhimit me të gjithë pjesën ka përfunduar, përsëri pjesa e sipërme kthehet në ballinë, ngjitet me tabanicë dhe përfitohet prodhimi i gatshëm-final. Fazat e lëvizjes së gjilpërës 1 dhe 2, si dhe pamja e gjysmëprodhimit, pasi të kthehet në ballinë, dhe para se të ngjitet në tabanicë, siç janë paraqitur në figurën 53.



Figura 53. Lëvizja e gjilpërës gjatë qepjes dhe pamja e prodhimit të përfunduar, pa ngjitjen e tabanicës

6.2 Përforcimi i nënthembrës

Ngjitja e nënthembrës mund të bëhet në disa mënyra, që varet nga ajo nëse punohet për:

- nënthembër e renditur ose mur
- përforcim vetëm i thembrës
- gjon bashkë me thembra
- takë të ulët apo të lartë
- nëse nënthembra është me ose pa takë

Përforcimi i nënthembrës në raste të shumta kryhet me:

- thumbim
- vidë
- ngjitje

Përforcimi i thembrës me thumbim kryhet në mënyra të ndryshme dhe varet nga lloji i këpucëve. Vetëm te këpucët për femra me takë të lartë përforcimi kryhet me vida. Ngjitja si mënyrë për përforcimin e thembrave aplikohet te thembrat me tape (tapa) dhe materiale të tjera me lartësi të ulët.

6.2.1 Përforcimi i nënthembrës me vidë

Përforcimi i nënthembrës me vida te nënthembrat e femrave me takë të lartë kryhet në një makinë me mbajtës të poshtëm, e cila është në formë të tubit (gypit). Në mbajtësin në formë të gypit në fund është vendosur -futur vidë me kokën poshtë dhe me majën lartë. Gjysmëprodhimi vendoset në mbajtëse së bashku me kallëpin dhe pjesën e tabanicës, në fakt gypi mbështetet në krye të kallëpit në pjesën e thembrës. Atëherë, në këtë pozitë, me pjesën e tabanicës lartë, në thembër vendoset edhe nënthembra dhe kështu në këtë pozicion përforcohet nënthembra me mbajtës në makinë. Aktivizohet mekanizmi për përmylljen e vidës që kalon nëpër nënthembrën dhe gjon. Kjo arrihet duke mbajtur vazhdimisht nënkëpucën (papuçen), dhe me lëshimin lirohet edhe gjysmëprodhimi.

Te ky lloj nënthembre duhet të merret parasysh mos të kalojë vida midis pjesës në formë të pirunit metalik ku bëhet përforcimi i tabanicës te gjysmëprodhimi (shih figurën 54).




Figura 54. Përforcimi i nënthembrës me vidë

6.2.2 Përforcimi i nënthembrës me thumbim

Përforcimi i nënthembrës me thumbim kryhet në dy mënyra, dhe atë, kur thumbimi i thumbave-gozhdëve zbatohet nga:

- pjesa e poshtme drejtë nënthembrës
- pjesa e sipërme drejtë nënthembrës

6.2 1.2 Përforcimi i nënthembrës nga pjesa e poshtme

Përforcimi nënthembrës nga ana e poshtme kah thembra kryhen në makinat me çekiç që përdoren për thumbim në anën e poshtme (figura 55). Kjo makinë ka një mbajtës në pjesën e poshtme në formën e thembrës dhe ka kanale të shumta nëpërmjet të cilëve kalojnë thumbat dhe çekiçët bëjnë nguljen e thumbave-gozhdëve.

Principi i punës së makinës është se gjysmëprodhimi pa kallëp vendoset në pjesën e thembrës në mbajtësin e poshtëm, dhe gjoni është kthyer nga ana e sipërme.

Nëpërmjet një pjese të thembrës vendoset pjesa e sipërme dhe përforcohet me përforcuesin e sipërm. Nëse pozita e gjysmëprodhimit është e vendosur mirë

me shtypjen e mekanizmit, aktivizohet mekanizmi për thumbim, nëpër të gjitha shtresat, astar, lubot, tabanicë dhe bëhet thembra.

Mbajtësi i poshtëm ku gjendet edhe çekani mbushet automatikisht ose me dorë me thumba për përforcimin e thembrave.

Mbajtësi i sipërm




Figura 55. Përforcimi i nënthembrave nga ana e sipërme

6.2.2.2 Përforcimi i nënthembrës nga ana e sipërme

Te kjo mënyrë e përforcimit të thembrës, gjysmëprodhimi pa kallëp vendoset në mbajtësin e poshtëm që është në formë të shpimit-shilkës. Në pjesën e thembrës vendoset gjysmëprodhimi në pjesën e thembrës dhe përforcohet me mbajtësin e sipërm. Në mbajtësin e sipërm është një bllok me çekiq dhe bllok me kanale nëpër të cilët kalojnë thumbat. Me aktivizimin e makinës, aktivizohen çekiqi që kryen nguljen e thumbave në thembër (figura 56).




Figura 56. Thumbimi i thembrës nga ana (pjesa) e sipërme

Pyetjet:

- Në sa faza punon gjilpëra te makina për thumbim?
- Si zhvillohet qepja?
- Çka gjendet në mbajtësin e poshtëm te makina e qepjes?
- Në sa faza punon gjilpëra te makina e qepjes?
- Çfarë është e nevojshme për kualitetin-cilësinë e qepjes?
- Çka ngjitet me qepjen anësore?
- Me çka është e furnizuar makina për qepje anësore?
- Në sa faza punon gjilpëra te makina qepëse anësore?
- Si bëhet qepja anësore?
- Prej çka varet cilësia e këpucëve me ngjitje?
- Prej çka përbëhet përgatitja e ngjitësit?
- Prej çfarë përbëhet përgatitja e pjesës tërheqëse të sipërme dhe thembrat?
- Kur bëhet riaktivizimi i ngjitësit?
- Prej çka përbëhet riaktivizimi i ngjitësit?
- Kur bëhet adaptimi i thembrës dhe gjysmëprodhimit?
- Çfarë është spërkatja -stërpikja?
- Cilat materiale shfrytëzohen për spërkatje-stërpikje?
- Çfarë është vullkanizimi?
- Cilat kushte janë të nevojshme për vullkanizim?
- Çfarë ndryshimesh ndodhin në procesin e vullkanizimit?
- Në çfarë pozicioni kryhet ngjitja te këpucët shtëpiake-antillop?
- Në sa mënyra mund të bëhet përforcimi i nënthembrës?
- Sqaro si bëhet përforcimi i nënthembrës nga ana e poshtme, dhe si nga ana e sipërme?

TEMA 7 FAZA FINALE

7.1 Karakteristikat e përgjithshme

